



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Zline Company shpk” të datës 24.01.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve në Mramor - Ritender” me nr. të prokurimit 616-26-62-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Zline Company shpk” të datës 24.01.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve në Mramor - Ritender” me nr. të prokurimit 616-26-62-5-2-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Zline Company shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 24.01.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve në Mramor - Ritender” me nr. të prokurimit 616-26-62-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi nr. 1 – “Në dosjen e tenderit në kuadër të kërkesave të stafit profesional ndër të tjera është kërkuar si vijon:

5. Një (1) Bachelor i ndertimtarise-drejtimi hidroteknike me 5 vite pervoje pune pas diplomimit dhe pas cerifikimit i licencuar me licence B nga ministria e mjedisit dhe I certifikuar ne menaxhimin e resurseve ujore te bazuara ne natyre-sasia,cilesia dhe shëndeti.

6. Një (1) Inxhinier i diplomuar ose master drejtimi Hidroteknikë me 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

9. Min 1. Punëtorë i certifikuar per manovrator (operues eskavatori);

10. Min 2 punetor te certifikuar si armirues.

Ne kemi analizuar me kujdes paramasën dhe duke marrë parasysh objektin e kontratës, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, kërkesat më sipër janë absolutisht të panevojshme. Kërkesa ku bachelor i ndertimtarise duhet të jetë nga drejtimi hidroteknik me 5 vjet përvojë të punës që duhet të ketë edhe licensë B si dhe certifikatë për resurse ujore, fillimisht është formuluar gabim sepse sipas LPP/RRPP ndalohet që të kërkohej një punonjës me 3-4 kualifikime si në rastin konkret. Në anën tjetër, nuk kemi të bëjmë me ndërtim të lartë dhe as me rregullim të shtretërve të lumenjëve, por vetëm me ndërtimin e rrugëve. Ngjashëm vlen edhe për kërkesën tjetër për një inxhinier të diplomuar ose master drejtimi hidroteknikë me 5 vjet përvojë pas diplomimit për shkak se në këtë projekt nuk kemi të bëjmë me ndërtim të lartë dhe as me pozicione të hidroteknikës. Ngjashëm vlen edhe për punonjësën e certifikuar si manovrator (eskavator), si dhe dy punonjësit e certifikuar si armirues, që po ashtu janë të panevojshme për shkak se nuk kemi të bëjmë me gërryerje të themelit apo armirim për ndërtim të lartë mirëpo projekti ka të bëjë vetëm me asfaltim të rrugës.

Përmes nenit 7 par. 1 dhe par. 2 të LPP përcaktohet si vijon

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik.

Nga sa u tha më sipër kërkesat më sipër janë jo vetëm të panevojshme por edhe diskriminuese të operatorët apo favorizuese për një operator specifik. Për këtë arsye kërkojmë nga AK që të largoj kërkesat për stafin profesional si vijon:

5. Një (1) Bachelor i ndertimtarise-drejtimi hidroteknike me 5 vite pervoje pune pas diplomimit dhe pas cerifikimit i licencuar me licence B nga ministria e mjedisit dhe I certifikuar ne menaxhimin e resurseve ujore te bazuara ne natyre-sasia,cilesia dhe shëndeti.

6. Një (1) Inxhinier i diplomuar ose master drejtimi Hidroteknikë me 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

9. Min 1. Punëtorë i certifikuar per manovrator (operues eskavatori);

10. Min 2 punetor te certifikuar si armirues”.

Pretendimi nr. 2 – “në kuadër të kërkesave lidhur me pajisjet në dosjen e tenderit aneksi 8 ndër të tjera janë kërkuar edhe pajisjet si në vijim:

#	Përshkrimi i pajisjes	Sasia minimale (copë)
1	Eskavator (luge ngarkuese) me fshese dhe pirunier 6-7 ton- librezë me regjistrim valid	2
4	Gjysme rimorkio speciale per sinjalizim- librezë me regjistrim valid	1
5	Makine per bluarjen e gurit -mobile 24 ton max- Fakturë ose DUD	1
6	Makine per montimin e kubezave dhe anesoreve te betonit-1.2-2 ton	2
8	Gjysmerimorkio speciale per shtrimin e bankinave dhe rigolave 2.5 ton max- librezë me regjistrim valid	1
9	Dron per matje gjeodezike	1
13	Makineri per prerjen-gryerjen e asfaltit 42 ton min	1
15	Rul per ngjeshjen e rrugeve me dhembaze 21.5-22.5 ton	1
24	Eskavator me zinxhir Gome 13.5 tone min fature ose Dud	1
25	Makineri vete levizese me zingjir gome per shpim dhe thyrje te betonit 1.4 tone max Fature ose DUD	1
26	Mini Dumper me peshore digjitale ,me peshe bartese 4 tone max me Dud	1

Ne kemi analizuar me kujdes paramasën dhe duke marrë parasysh objektin e kontratës, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, kërkesat më sipër janë absolutisht të panevojshme. Të gjitha funksionet e përcaktuara me këto pajisje, ose nuk janë të nevojshme për projektin, ose realizohen përmes pajisjeve tjera të mbetura. Pra nuk shërbejnë aspak për natyrën dhe qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit. Për më tepër, disa nga këto pajisje kanë peshë fikse që është absolutisht e ndaluar sepse formulimet e tilla përbëjnë shkelje absolute të nenit 7 dhe 28-29 të LPP. Përmes nenit 7 par. 1 dhe par. 2 të LPP përcaktohet si vijon

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.

Nga sa u tha më sipër kërkesat më sipër janë jo vetëm të panevojshme por edhe diskriminuese të operatorët apo favorizuese për një operator specifik. Për këtë arsye kërkojmë nga AK që të largoj kërkesat e cituara më sipër për pajisjet nga aneksi 8 i DT”.

Lidhur me pretendimet ankimore, pas analizimit me kujdes të kërkesave përkatëse të DT në kuptim të nenit 28 dhe nenit 29 lidhur me nenin 7 të LPP, është konstatuar se kërkesat e tilla nuk janë të domosdoshme. Prandaj pretendimet janë gjetur si të bazuara.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 26.01.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.